

A.Toptani Torre Drin, Nr.32, tel 2271576

Sot me date 04.02.2016 para meje notere Gentiana SHKODRA, me studio ne Tirane, ne adresen e larttreguar, u paraqiten personalisht:

1. **Z. Robert Dako**, i biri i Aleksander dhe Roza, lindur ne Tirane, me 18.10.1944, banues ne Koder Kamez Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. E41018031O, ne cilesine e ortakut te vetem te Shoqerise “**Sevasti & Parashqevi Qiriazhi**” Shpk, me seli ne Tirane, ne Ish-Fakultetin e Inxhinierise se Pyjeve, Instituti Bujqesor, Koder Kamez, NIPT K61830001K, ne cilesine e SHITESIT
2. **Z. Aleks ULDEDAJ**, i biri Gjoke dhe Roze, lindur ne Lezhe, me 24.01.1992, banues ne Tirane, rruga “Myslym Shyri”, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr.J20124069S, ne cilesine e BLERESIT

ndermjet te cileve eshte rene dakort dhe perpilohet sa me poshte vijon nje:

KONTRATE SHITJE KUOTASH


(Bazuar ne:

a- *bazuar ne nenet 705 e vijues KC*

b- *N.73 i ligjit 9901 date 14.04.2008 Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare)*

KUSHTE PARAKONTRAKTORE

- 1- Z.Robert DAKO eshte ortak me 100% ne kapitalin e shoqerise “SEVASTI & PARASHQEVI QIRIAZI”, NIPT K61830001K, me seli ne Tirane, me seli ne Tirane, ne Ish-Fakultetin e Inxhinierise se Pyjeve, Instituti Bujqesor, Koder Kamez.
- 2- Me vendimin e Ortakut te Vetem te shoqerise date 04.02.2016 eshte vendosur shitja e kuotave te mbajtura nga Z. Robert DAKO ne favor te Z. Aleks ULDEDAJ.
- 3- Shoqeria ushtron aktivitet ne fushen e edukimit te larte dhe ne daten e nenshkrimet te kesaj kontrate rezulton ne gjendje te pezulluar.
- 4- Pezullimi eshte vendosur ne baze te shkreses nr.8607/4 date 26.01.2015 leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane, ku eshte kerkuar: vendosja e Barres se Sigurise mbi titujt e pronesise, me qellim, moslejimin e tjetersimit te titujve te pronesise perfshire dhe shitblerjen e aksioneve (kuotave), deri ne shlyerjen e detyrimeve tatimore, nga ana e tatimpaguesit debitor.
- 5- Pala Shitese deklaroi se ka likuiduar detyrimet tatimore dhe taksat lokale dhe Zyra e Tatim Taksave ka leshuar shkresen perkatese per fshirjen e pezullimit nga kuotat dhe lejimin e tjetersimit te kapitalit te shoqerise.
- 6- Pala parashikojne qe Pala Blerese, me kerkesen e Pales Shitese, mund te kontribuojne ne likudimin e detyrimeve te prapambetura, por ne cdo rast, do te behet ortak i vetem i shoqerise, mbajtes i 100% te kapitalit, me vleren nominale 100.000 leke.



- 7- Përvec negociatave për blerjen e kuotes, palet kontraktore po negociojnë dhe për shitblerjen e disa pasurive të paluajtshme, kushtet e të cilave do të përcaktohen në kontrata të posaçme për shitjen e pasurive të paluajtshme, sipas dispozitave të Kodit Civil.

Duke marrë në konsideratë sa më lart, palet përcaktojnë si më poshtë vijon:

PALET KONTRAKTORE:

Z. Robert DAKO në këto kontrata do të paraqitet me cilësinë e PALES SHITËSE dhe për efekt të kësaj kontrate do të referohemi me këto emertim, ndërsa **Z. Aleks ULDEDAJ** në këto kontrata do të paraqitet me cilësinë e PALES BLERËSE dhe këtu e në vijim do të referohemi me këto emertim.

OBJEKTI I KONTRATES:

Me anë të kësaj SHITESI transferon në mënyrë të përvokueshme totalin prej 100% të kapitalit, me vlerën nominale 100.000 leke, në favor të BLERËSIT, i cili pranon titullin e tij të pronësive mbi kuotën objekt – kontrate.

Aktualisht, në përputhje me statutin ekzistues të shoqërisë, dhe me gjendjen rezultuese nga Ekstrakti i Qendres Kombëtare të Regjistrimit, kapitali është i përbërë nga 100 kuota, por konform ndryshimeve të bëra në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në nenin 68 pika 2 ku është parashikuar shprehimisht se “Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zoteron një kuotë të vetme në shoqëri...” dhe pse ortaku i vetëm nuk ka bërë vendim të posaçëm për përshatjen e statutit me ndryshimet aktuale ligjore, automatikisht ipso iure, kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë dhe ortaku i shoqërisë Z. Robert DAKO është zotues i një kuote të vetme, baraz me 100% të kapitalit, me vlerën 100.000 leke.

CMIMI KONTRAKTOR:


Palet janë marrë vesh që kuota objekt kontrate shitet me një cmim të barabartë me vlerën nominale prej 100.000 (njëqindmijë) leke.

Cmimi kontraktor do të likuidohet midis paleve me rrugë bankare, ose me çdo mënyrë tjetër të ligjshme, sipas marrëveshjes së paleve.

DOKUMENTA BASHKËNGJITUR KONTRATES:

Të gjitha negociatat paraprake të paleve, vendimi i tyre për përcaktimin e madhësisë së cmimit kontraktor, për detajimin e cmimit kontraktor janë bazuar dhe përcaktuar bazuar në dokumentacionin si në vijim:

- Vendimin e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë “Sevasti & Parashqevi Qiriazi” Sh.p.k. datë 04.02.2016 për shitjen e kuotes;
- Pasqyrat financiare të shoqërisë “Sevasti & Parashqevi Qiriazi” Sh.p.k. Pala shitesë garanton se gjendja financiare e shoqërisë e reflektuar në këto pasqyra



eshte gjendja reale financiare e shoqerise. Pala shitese garanton mungesen e detyrimeve te tjera te paperfshira ne bilanc;

- Inventaret e aseteteve te levizshme;
- Lista e studenteve debitore ndaj Universitetit dhe shumat perkatese te detyrimeve;
- Dokumentacioni i lidhur me Licensen e Universitetit;
- Vertetimet dhe diplomat e plotesuara te studenteve;
- Ne rast se pas shitjes se kuotes se kapitalit te shoqerise "Sevasti & Parashqevi Qiriazhi" Sh.p.k. konstatohet ekzistenca e detyrimeve te paperfshira ne bilanc, te krijuara para dates se nenshkrimimit te kontrates se shitjes se kuotes, Pala Blerese duhet te njoftoje me shkrim Palen Shitese per detyrimin e shfaqur. Pala Shitese ne nje rast te tille do te angazhohet per sqarimin e situates, ose per provimin e mosekzistences se detyrimit, ose per pagimin e detyrimit ndaj kreditorit me mjete te veta monetare, ose ne rastin me te keq do te pranoje uljen e cmimit te shitjes se pasurive te paluajtshme, te permendura ne piken 6 te kushteve parakontraktore.

DEKLARIME:

BLERESI deklaron se pranon t'i bleje kuotat me te gjitha te drejtat dhe detyrimet e lidhura me to, ne shifrat qe rezultojne nga bilanci i shoqerise bashkengjitur kontrates.

EFEKTET JURIDIKE:

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe regjistrimin e kalimit te kuotes, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 « Per Qendren Kombetare te Regjistrimit », pjesemarrja ne kapitalin e shoqerise «SEVASTI & PARASHQEVI QIRIAZI» SHPK paraqitet si vijon :

Z. Aleks ULDEDAJ – ortak per 100% te kapitalit, baraz me 1 kuote, me vleren nomlane 100.000 (njqindmije) leke.

DITA EFEKTIVE E KONTRATES:


Kjo kontrate hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimimit te saj. Kontrata eshte e vlefshme ne rast se nenshkruhet para noterit.

Sa me lart, lexohet nga palet dhe nenshkruhet lirisht prej tyre:


PALET KONTRAKTORE

PALA SHITese

PALA BLERese




ROBERT DAKO



ALEKS ULDEDAJ

Deklaroj une notere Gentiana Shkodra se dhashe asistencen ligjore dhe perpilova kontraten e shitjes se kuotave si me lart dhe se palet per identitetin e te cileve jam e bindur, nenshkruan rregullisht para meje, ne thember te aktit te mesiperm. E legalizoj aktin sipas ligjit. Prodhuar ne kater ekzemplare me vlere te njejte ligjore.



Gentiana SHKODRA / Notere



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	K61830001Q	
2. Data e Regjistrimit	25/02/2004	
3. Emri i Subjektit	SEVASTI & PARASHQEVI QIRJAZI	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	20/02/2004	
6. Kohëzgjatja	Nga: 20/02/2004 Deri:	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE ISH FAK. INXH. PYJ.INST BUJQES	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Te formoj specialitet te larte ne fushen e shkences ekonomike, jurisprudence, edukimin fizik dhe sporteve, disiplinave. Te kryej studime, kerkime e publikime ne fusha e disiplinat e mesiperme. Te kryej kualifikime shkencore pasuniversitare, kurse specializimi, trajnimi e kualifikimi ne shkencat e disiplinat e mesiperme. Me kapacitetet e veta te lira te trupes akademike te realizoj projekte te ndryshme lidhur me legjislacionin, problemet e zhvillimet ekonomike.	
10. Administratori/ët	Robert Dako	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 08/10/2013	Deri: 07/10/2016
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Robert Dako	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	100,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Tirane TIRANE Furgon me Targe TR 8105P	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: "SEVASTI & PARASHQEVI QIRJAZI"	



	Telefon: 0682063042
15. Statusi:	Pezulluar



Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga WEB

